

24.08.2026

**I nderuar Famullitar i Kishës Shën Nënë Tereza në Dugajevë,
Don Ambroz Demaj,**

Në një bisedë telefonike me anëtarin tonë të stafit organizativ, z. Marjan Gojani, kemi diskutuar edhe një herë nevojën për të pasur një bilanc të përgjithshëm të projektit, si në aspektin financiar, ashtu edhe në atë të punimeve të realizuara dhe atyre që kanë mbetur për t'u përfunduar.

Duke qenë se punimet në Kishë tashmë janë në fazën përfundimtare, dëshirojmë ta përsërisim edhe një herë, siç e kemi theksuar shumë herë deri më tani, se ka ardhur koha e duhur për të pasur një pasqyrë të qartë, të plotë dhe transparente të gjendjes së projektit.

Në veçanti, do të ishte e nevojshme të kemi një pasqyrë të:

- të hyrave nga donacionet në euro, dollarë amerikanë dhe franga zvicerane;
- krahasimit të tyre me të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të Kishës;
- gjendjes së llogarisë bankare të Kishës Shën Nënë Tereza në Dugajevë dhe mjeteve financiare në dispozicion;
- obligimeve dhe borxheve të mbetura;
- shpenzimeve të realizuara deri më tani;
- punëve të përfunduara dhe atyre që ende kanë mbetur, së bashku me kostot e pritshme për përfundimin e tyre.

Dua të theksoj edhe një herë se qëllimi i kësaj kërkesë nuk është krijimi i tensioneve, por një vlerësim i hapur, i qartë dhe konstruktiv i gjendjes aktuale, në mënyrë që së bashku ta çojmë projektin drejt përfundimit.

Do të jem në Kosovë nga data 3 deri më 6 shtator, së bashku me një delegacion nga Austria, dhe do të doja ta shfrytëzonim këtë mundësi për t'u takuar dhe për t'i diskutuar nga afër këto çështje.

Më datën 3 shtator do të jem i angazhuar me delegacionin, ndërsa më datat 4, 5 dhe 6 shtator jam i gatshëm ta përshtat orarin tim sipas mundësive tuaja.

Do ta vlerësoja shumë nëse do të më njoftoni më së largu deri të dielën, më 30.08.2026, për mundësinë, vendin dhe kohën e takimit, pasi pas kësaj date nuk do të kem më mundësi ta ndryshoj agjendën time gjatë vizitës në Kosovë.

Me respekt dhe mirënjohje,

Kolë Berisha

P.S.: Ju lutem, na njoftoni edhe për datën e përrurimit të Kishës ose, nëse ende nuk është përcaktuar përfundimisht, për datën e përafërt, në mënyrë që të kemi mundësi t'i njoftojmë me kohë të gjithë, veçanërisht mysafirët ndërkombëtarë, në mënyrë që ata të kenë kohë të mjaftueshme për të planifikuar pjesëmarrjen e tyre.

Përmbledhje e komunikimit dhe kërkesave për bilancin e projektit

Duhet të theksohet se kërkesa për një bilanc të plotë, të saktë dhe transparent të projektit të ndërtimit të Kishës Shën Nënë Tereza në Dugajevë nuk është bërë vetëm një herë. Në mënyrë të përsëritur, si me shkrim ashtu edhe nëpërmjet bisedave telefonike, është kërkuar që të përgatitet një pasqyrë e plotë e gjendjes financiare dhe të punimeve të projektit, së bashku me të gjitha grupet e punës të përfshira në realizimin e tij.

Nga ana ime ka pasur vazhdimisht gatishmëri të plotë për të udhëtuar në Kosovë dhe për të zhvilluar një takim të përbashkët me të gjitha grupet e punës. Qëllimi ka qenë që, në praninë e të gjithë personave përgjegjës, të përgatitej një bilanc i saktë dhe i dokumentuar, duke përfshirë të gjitha të hyrat nga donacionet, shpenzimet e realizuara, gjendjen e saktë të llogarive bankare, obligimet dhe borxhet e mbetura, si dhe punimet e përfunduara dhe ato që kanë mbetur për t'u realizuar.

Qëllimi i këtij procesi ka qenë që të gjitha palët, dhe veçanërisht të gjithë donatorët, të kishin një pasqyrë të njëjtë, të qartë dhe të verifikueshme të gjendjes reale të projektit dhe të financave të tij. Mbi bazën e këtij bilanci të plotë dhe të dokumentuar, synohej që së bashku dhe në mënyrë transparente të përcaktoheshin hapat e mëtejshëm për përfundimin e projektit.

Megjithatë, pavarësisht gatishmërisë time të përsëritur për të ardhur në Kosovë dhe për ta zhvilluar këtë proces së bashku me të gjitha grupet e punës, Don Ambroz Demaj e ka refuzuar në mënyrë të përsëritur kërkesën për një bilanc të përbashkët dhe të plotë. Për këtë arsye, deri më tani nuk është zhvilluar asnjëherë një takim i përbashkët ku të gjitha grupet e punës të kenë marrë pjesë në përgatitjen dhe dokumentimin e një bilanci të plotë të projektit dhe të gjendjes së llogarive.

Më datën 24.08.2026, kjo kërkesë është përsëritur edhe një herë me shkrim drejtuar Famullitarit të Kishës Shën Nënë Tereza në Dugajevë, Don Ambroz Demaj. Në këtë kërkesë është theksuar se, duke qenë se punimet në Kishë ndodhen tashmë në fazën përfundimtare, ka ardhur koha e duhur për të pasur një pasqyrë të qartë, të plotë dhe transparente të gjendjes së projektit.

24.08.2026

Në mënyrë konkrete është kërkuar pasqyra e të hyrave nga donacionet në euro, dollarë amerikanë dhe franga zvicerane; krahasimi i tyre me të dhënat e publikuara në faqen zyrtare të Kishës; gjendja e llogarisë bankare të Kishës Shën Nënë Tereza në Dugajevë dhe mjetet financiare në dispozicion; obligimet dhe borxhet e mbetura; shpenzimet e realizuara deri më tani; si dhe punët e përfunduara dhe ato që ende kanë mbetur, së bashku me kostot e pritshme për përfundimin e tyre.

Në të njëjtën kërkesë është bërë e ditur se nga data 3 deri më 6 shtator 2026 do të jem në Kosovë së bashku me një delegacion nga Austria dhe se datat 4, 5 dhe 6 shtator ishin lënë në dispozicion për një takim të përbashkët, sipas mundësive të Famullitarit. Kjo ishte një mundësi konkrete për ta zhvilluar më në fund takimin e kërkuar dhe për ta dokumentuar së bashku gjendjen reale të projektit.

Megjithatë, edhe kësaj here, më datën 24.08.2026, Don Ambroz Demaj e ka refuzuar mundësinë e zhvillimit të këtij takimi.

Për këtë arsye, bashkëngjitur këtij dokumenti do të paraqitet edhe korrespondenca e fundit përkatëse, përfshirë komunikimet përmes WhatsApp-it dhe komunikimet e tjera me shkrim, të cilat dokumentojnë kërkesën e përsëritur për një bilanc të plotë dhe transparent, gatishmërinë time për të ardhur në Kosovë dhe për të zhvilluar një takim të përbashkët me të gjitha grupet e punës, si dhe përgjigjen e marrë më datën 24.08.2026.

BASHKËNGJITJE


Korrespondenca e fundit përmes WhatsApp-it

Në vijim paraqitet korrespondenca e fundit përmes WhatsApp-it, e datës 24.08.2026, lidhur me kërkesën për një takim të përbashkët dhe për përgatitjen e një bilanci të plotë, të saktë dhe transparent të projektit.

Kjo korrespondencë dokumenton kërkesën time për zhvillimin e takimit, gatishmërinë time për të ardhur në Kosovë dhe për ta zhvilluar këtë proces së bashku me të gjitha grupet e punës, si dhe përgjigjen e marrë nga Don Ambroz Demaj.

Korrespondenca WhatsApp – 24.08.2026

Kolë Berisha – 24.08.2026



Don Ambroz Demaj – 24.08.2026

Pershendetje. Me dt. 1 Korrik 2026, e kemi bere publike daten e bekimit te kishes se re, ne faqen zyrtare te famullise se Gllaviçicës FB. Per datat e tjera nuk mund ti pergjigjem asnje date per shkaka te angazhimeve te mia personale.

14:46

Përfundim

Kjo korrespondencë e fundit, së bashku me komunikimet e mëparshme, tregon se kërkesa për një bilanc të plotë, të saktë dhe transparent të projektit është bërë në mënyrë të përsëritur. Nga ana ime ka pasur gatishmëri të vazhdueshme për të ardhur në Kosovë, për t'u takuar me të gjitha grupet e punës dhe për të dokumentuar së bashku gjendjen financiare dhe teknike të projektit.

Qëllimi ka qenë dhe mbetet që të gjithë donatorët dhe personat e përfshirë të kenë një pasqyrë të qartë, të njëjtë dhe të verifikueshme të gjendjes së projektit dhe që, mbi këtë bazë, hapat e mëtejshëm për përfundimin e Kishës të përcaktohen së bashku dhe në mënyrë transparente.